



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE INTEGRIMIT

Nr.836/1 prot.

Tiranë më 4.5.2023

Lënda: Mbi ridërgimin për mendim të projektligjit “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes në Sistemin Penitenciar”

MINISTRISË SË DREJTËSISË

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj nr. 466/12 prot., datë 26.04.2023, me anë të së cilës ridërgohet për mendim projektligji “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes në Sistemin Penitenciar” (në vijim “projektligji”) si dhe dokumentet shoqëruese.

Nga shqyrtimi i projektligjit të ridërguar, Zyra e Komisionerit vlerëson në tërësi marrjen në konsideratë të sugjerimeve të dhëna nga ana jonë me shkresën nr. 240/1 prot., datë 08.02.2023, megjithatë vëren nevojën e disa saktësimeve mbi reflektimet e bëra në këtë draft.

Në lidhje me nenit 25 të projektligjit në të cilin parashikohet “Përjashtimi nga publikimi”, vlerësojmë se togfjalëshi “...legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit” të hiqet pasi përbën përsëritje të referencës ligjore të parashikuar në këtë nen.

Në pikën 2, të nenit 56 të projektligjit, pas togfjalëshit: “... për mbrojtjen e të dhënave”, të shtohet fjala “personale” sikurse është sugjeruar më herët, dhe jo “penale”.

Me përfshirjen e sugjerimeve të mësipërme projektligji vlerësohet i hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi